



Prishtinë: 24 qershor 2008
Kodi i ZRRE-së: D_099_2008
Nr.i Referencës: ZRRE/DMK_R_94_06_08

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK_R_94_06_08; dhe
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2008 nxori këtë:

VENDIM

PRANOHET ankesa e konsumatorit Agim Ajvazi (shifra e konsumatorit në KEK: DPR – 90011745) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

1. Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së të ZRRE-së të datës 04 mars 2008 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 29 shkurt 2008, lidhur me parapagimin për RTK.
2. Me datë 11 dhjetor 2007 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar parapagimin për RTK.
3. Me datë 29 shkurt 2008 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2003/12.

Provë: Përgjigja e KEK-ut

4. Me datë 04 mars 2008 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.

Provë: Ankesa e konsumatorit

5. DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut dhe konsumatorit, ka vërejtur se:

- 5.1 Konsumatori ka regjistruar biznesin me datë 22 gusht 2000 në Administratën e Përkohshme Civile të OKB-së.



Provë: Certifikata e Regjistrimi të biznesit 80159030

- 5.2 Konsumatori ka nxjerrë nga Administrata Tatimore Certifikatën Tatimore e cila l është dhënë sipas kërkesës së tij të datës 27 dhjetor 02 me qëllim të çregjistrimit të subjektit në fjalë.

Provë: Certifikata tatimore e Administratës Tatimore

- 5.3 Konsumatori ka nxjerrë një dokument nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me datë 23 maj 2003 në të cilin dokument theksohet se biznesi nr. 80159030 me pronarin Bekim Ajvazin, me seli në Prishtinë ka qenë i regjistruar në Entin e Statistikor të Kosovës dhe ka vepruar që nga janari i vitit 2001. Pronari ka kërkuar që këtë biznes ta SHUAJ me datë 23.05.2003, sipas vërtetimit të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë Biznesi shuhet që nga data 23 maj 2003.

Provë: Vërtetimi i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë i datës 23 maj 2003

- 5.4 Nga kartela e transaksioneve të konsumatorit shihet se ka një mungesë të shënimeve për konsumatorin që nga muaji shkurt 2003 deri në muajin e maj 2004, sipas informatave të KEK-ut është e mundur që konsumatori për këtë periudhë kohore është trajtuar si konsumator pasiv.

Provë: Kartela e transaksioneve të konsumatorit

- 5.5 Nga kartela e konsumatorit shihet se që nga muaji janar 2005 konsumatori është ngarkuar vetëm me taksën për RTK që do të thotë se ky konsumator nuk ka pas konsum të energjisë në këtë pikë matëse.

- 5.6 Konsumatori nuk posedon ndonjë dokument në të cilën ai ka bërë kërkesë në KEK për pasivizimin e njehsorit elektrik.

- 5.7 KEK-u e ka faturuar konsumatorin edhe pas shuarjes së biznesit.

6. DMK e ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga KEK Sh.A dhe konsumatori i **rekomandon** Bordit të ZRRE-së që të **pranohet** ankesa e konsumatorit ngase: Në bazë të shënimeve të paraqitura në kartelën e konsumatorit shihet se nga muaji janar 2005 konsumatori është ngarkuar vetëm me taksën për RTK. KEK-u është dashur që ta informojë konsumatorin se ai duhet të bëjë kërkesë për pasivizimin e njehsorit elektrik pasi që e ka shuar biznesin. Konsumatori nuk ka qenë në dijeni që ai duhet të bëjë kërkesë për pasivizimin e njehsorin duke menduar se me shuarjen e biznesit nuk ka obligime tjera. Nga palët kërkohet:

- 6.1 KEK-u ta shkarkoi kartelën e konsumatorit nga janari 2005 deri në datën e lëshimit të këtij vendimi.
- 6.2 KEK-u duhet të gjejë listat e leximit të konsumatorit prej muajit maj 2003 deri në muajin dhjetor 2004, dhe nëse rezulton se konsumi ka qenë zero atëherë ta shkarkoi kartelën e konsumatorit edhe për këta muaj.



- 6.3** KEK-u ta shkarkoi kartelën e konsumatorit për 3 njoftimet e fundit për shkyçje, ngase pas njoftimit të parë nuk ka veprime të ndërmarra nga KEK-u apo konsumatori dhe për këtë KEK-u është dashtë të thirret në njoftimin e parë dhe të mos dërgoi njoftimet pasuese.
- 6.4** Konsumatori të bëjë kërkesën formale për pasivizimin e njehsorit, kurse KEK-u të bëjë pasivizimin e këtij njësori.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që të pranojë ankesën e konsumatorit për arsye të paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërmbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Nysret Avdiu, Anëtar